



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:042446  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05499631

**A.C.nr.7084/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryetar, Enes Mehmeti, dhe Halide Reka, anëtar, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Komuna Prishtinë, e përfaqësuar nga Besiana Duraku, kundër të paditurit A.(H).H. me vendbanim në Rr. “...” nr..., Komuna Pejë, për shkak të rimbursimit të dëmit, vlera e kontestit 989.00 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.394/20 datë 22.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 25.03.2024, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e të paditurit A.(H).H. me vendbanim në Rr.“...” nr..., Komuna Pejë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.394/20 datë 22.07.2021, **VËRTETOHET**.

## **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.394/20 datë 22.07.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

*“... APROVOHET në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditëses: Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, rr. “Lidhja e Pejës” Magj.Prishtinë – Fushë Kosovë, p.n.*

*I. DETYROHET i padituri A.(H).H. rr.”...” nr..., Pejë, që paditëses Byrosë Kosovare të Sigurimit ti paguaj shumën prej 989.00 Euro, në emër të rimbursimit të dëmit, të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 16.08.2014, në Klinë dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vite pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 18.03.2020, e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto ti përmbush në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit së këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.*

*II. OBLIGOHET i padituri A.(H).H. rr.”...” nr..., Pejë, që paditëses Byrosë Kosovare të Sigurimit ti kompensoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 20,00 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit së këtij aktgjykimi...”*

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim Gjykatës së Apelit, ta aprovojë në tërësi ankesën e të paditurit si të bazuar, , dhe lënda të kthehet në rivendosje dhe rigjykim gjykatës së shkallës së parë, ose të ndryshohet aktgjykimi.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se :

**- Ankesa e të paditurit, është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Komuna Prishtinë, me datë 10.03.2020, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur padi ndaj të paditurit A.(H).H. me vendbanim në rr.”...” nr..., Komuna Pejë, me kërkesë për rimbursim të dëmit material dhe jo material.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 22.07.2021, dhe pas dëgjimit të palëve dhe pas administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.394/20 datë 22.07.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, Byroja Kosovare e Sigurimit, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

*Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimin të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: “...Meqenëse paditësi në bazë të provave prezent në shkresat të lëndës ka përmbushur detyrimin ndaj të dëmtuarit si pasoj e këtij aksidenti ka të drejtë që të kërkojë rimbursimin e shumës së paguar në bazë të nenit 18.4, Ligjit Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia me nr. 04/L -018, e cila shprehimisht parasheh se: Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat...”*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë është i drejtë dhe i bazuar, sepse me dispozitën e nenit 18.1 të Ligji Nr.04/L-018 Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia parashihet: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”,* ndërsa me dispozitën e nenit 18.4 parashihet: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”.* Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Pretendimi ankimor i paditësit se Gjykata është dashtë që së paku të bëjë një ekspertizë të komunikacionit, ky pretendim është i pa bazuar pasi që në shkresat e lëndës është ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Ing. i dip. S.B., datë 08.11.2014, i cili ekspert në ekspertizë ndër të tjera ka deklaruar se *“...Deri te aksidenti ka ardhur për shkak të ngasësit të automjetit B i markës “...” me ngjyrë të gjelbert i cili gjatë ngasjes së automjetit (Kamionit) nuk ka qenë i kujdesshëm...”*, ndërsa pala e paditur nuk ka kërkuar nga Gjykata me caktua ekspertizë tjetër të komunikacionit.

Pretendimi ankimor i të paditurit se meqë nuk ka marrë pjesë në gjykim thirret në parashkrimin e kërkesë padis, ky pretendim është i pa bazuar pasi që në seancën e mbajtur në Gjykatë me datë 24.05.2021, konstatohet nga Gjykata e shkallës së parë se prezent në këtë seancë ka qenë edhe pala e paditur.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor të palës së paditur se kemi të bëjmë me aplikim të gabuar të drejtës materiale, dhe shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të palës së paditur, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartpërmendurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

**GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**A.C.nr.7084/2021 datë 25.03.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari,**  
**Bujar Muzaqi**